



REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. <u>01-762/14</u>
Dep. <u>03</u>	Prot. No. <u>04.03.2014</u>
Nr. lfaq. <u>03</u>	Data <u>04.03.2014</u>
Broj stranica <u>03</u>	Datum <u>04.03.2014</u>
Nr. pages <u>03</u>	Date <u>04.03.2014</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	04.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	Zyra Koordinuese e Komisionit Ad-hoc Parlamentar për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtar të Komisionit të Pavarur për Media
CC:	Komisioni Ad-hoc Parlamentar për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtar të Komisionit të Pavarur për Media
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



Te nderuar,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesën me numër të protokollit 03-759/14, nga Kryetarja e Komisionit Ad-hoc Parlamentar për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, që të sqarohet përmbajtja e nenit 12 (paragrafi 1.3) i Ligji nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave si dhe nenit 4 (paragrafi 1.13) të Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se Agjencia kundër Korrupsionit është institucion i pavarur të cilit me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta. Sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën edhe mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore. Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj, në lidhje me interpretimin për disa pika të ligjeve që juve ju intereson, ju njoftojmë se bazuar në kompetencën dhe autoritetin tonë të dhënë me ligj në mund të paraqesim vetëm opinion ligjor lidhur me çështjen e ngritur me paqartësinë tuaj lidhur me përmbajtjen e nenit 4 (paragrafi 1 .13) të Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Ju njoftojmë se në kuptim të neni 4 të këtij ligji janë paraparë ushtruesit e funksioneve publike që janë objekt i trajtimit të Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Andaj, bazuar në këtë dispozitë të gjithë personat që ushtrojnë këto funksione konsiderohen zyrtare të lartë dhe kanë për obligim parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik duke respektuar detyrimet, rregullat, kufizimet që rrjedhin në ushtrimin e funksionit publik.

Ju përkujtojmë së në bazë të nenit 4 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.13) të Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, parashihet që zyrtar i lartë publik janë edhe Drejtorët e të gjitha Departamenteve, Udhëheqësit e Financave dhe Prokurimit Publik në të gjitha institucionet publike, si në rastin e aplikantit për pozitën Anëtar i Komisionit të Pavarur për Media. Po ashtu, ju njoftojmë se bazuar në nenin 7 (paragrafi 8) të këtij ligji, ndër të tjera përcaktohet se zyrtari i lartë nuk duhet të lejojë që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij publik. Ai duhet të shmangë konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real apo i mundshëm,

Më tej sipas nenit 16, (paragrafi 1) të Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, përcaktohen kufizimet për zyrtarin e lartë, i cili nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit. Kështu, çështja e ngritur nga ju për pozitën e kandidatit për Anëtar të Komisionit të Pavarur për Media, në të cilën ka aplikuar kandidati i cili mban pozitën e Drejtorit në Shërbimin Civil, nëse arrin të zgjedhet dhe vazhdon të ushtroj këto dy pozita konsiderohet se është në papajtueshmëri dhe në kundërshtim me nenin 16 (paragrafi 1) të këtij ligji. Rrjedhimisht, në këtë situatë për të shmangur lindjen e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve, ju rekomandojmë që në rast se i njëjti arrin të zgjedhet në pozitën e lartpërmendur, duhet detyrimisht që të ofrojë dorëheqjen nga njëra pozitë. Kjo për faktin se këto dy pozita konsiderohen si funksione publike sipas Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, dhe paraqesin papajtueshmëri në ushtrimin e funksioneve.

Bazuar në faktet e lartpërmendura, ju rekomandojmë që të veproni konform këtij opinioni, duke i ndërmarrë të gjitha masat konform këtij opinioni dhe dispozitave ligjore në fuqi për të parandaluar dhe shmangur konfliktin e interesit.

Me respekt!

0105010